



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

GRUPI PARLAMENTAR I PARTSË SOCIALISTE

Nr. \_\_\_\_ Prot .

Tiranë, më \_\_\_\_ .2021

**Lënda :** Depozitim projektligji

**Drejtuar:**

**Z. GRAMOZ RUÇI  
KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË**

I nderuar Z.Kryetar,

Bazuar në nenin 81 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe nenit 68 të Rregullores së Kuvendit, Ju paraqes projektligjin “PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.98/2016 “PËR ORGANIZIMIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”.

**DEPUTETI PROPOZUES**

*Florbete Buresha*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. \_\_\_\_ / 2021

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.98/2016 “PËR ORGANIZIMIN  
E PUSHTETIT GJYQËSOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,**

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

Në ligjin nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa e ndryshime:

**Neni 1**

Në nenin 2, shkronja “e”, ndryshohet si më poshtë:

“e) “Ndihmës ligjor” është ndihmësi që ushtron funksionin e tij në njësinë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit.”

**Neni 2**

Në nenin 17, pika e 5, fjalia e parë, ndryshohet si më poshtë:

“Degët e gjykatave gjykojnë çështje civile dhe penale që gjykohen nga një gjyqtar i vetëm.”

**Neni 3**

Neni 24, ndryshohet si më poshtë:

Gjykatat me juridiksion të përgjithshëm të shkallës së parë dhe të apelit, gjykatat administrative të shkallës së parë dhe të apelit si dhe gjykata e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar të shkallës së parë dhe të apelit gjykojnë me trup

grykues të përbërë nga një gryqtar, ose me trup grykues të përbërë nga tri gryqtarë, sipas parashikimeve të ligjeve procedurale, përveç rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe.

#### **Neni 4**

Në nenin 26, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në fjalinë e dytë të pikës 3, pas togfjalëshit “mbledhja e përgjithshme e gryqtarëve” shtohet togfjalëshi “ndërmjet gryqtarëve që ushtrojnë funksionin në atë grykatë”.

2. Në pikën 4, fjalia e tretë ndryshohet si më poshtë:

“Mbledhja e përgjithshme e gryqtarëve është e vlefshme kur marrin pjesë shumica e anëtarëve që ushtrojnë detyrën në grykatë.”

3. Pas pikës 5, shtohet pika 5/1 me këtë përmbajtje:

“5/1. Në rastet kur nuk konkurren asnjë nga gryqtarët që plotësojnë kriterin e përvojës minimale profesionale, ose kur asnjë nga gryqtarët e grykatës nuk e ka këtë përvojë, zëvendëskryetari i grykatës zgjidhet ndërmjet gryqtarëve të tjerë që ushtrojnë funksionin në atë grykatë, për një mandat njëvjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.”

#### **Neni 5**

Në nenin 29, pika 1, pas fjalisë së parë, shtohen fjalitë me këtë përmbajtje:

“Në mbledhje marrin pjesë të gjithë gryqtarët që ushtrojnë detyrën. Mbledhja është e vlefshme kur marrin pjesë shumica e gryqtarëve.”

#### **Neni 6**

Në nenin 31, bëhet shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 2, fjalia e dytë, ndryshohet si më poshtë:

“Kolegji Civil grykon në kolegji me trup grykues të përbërë nga 3 gryqtarë. Në rastet e grykimeve për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gryqësore Kolegji Civil grykon në kolegje me trup grykues të përbërë nga 5 gryqtarë.”

2. Në pikën 3, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:

“Kolegji Penal grykon në kolegji me trup grykues të përbërë nga 3 gryqtarë. Në rastet e grykimeve për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gryqësore Kolegji Penal grykon në kolegje me trup grykues të përbërë nga 5 gryqtarë.”

3. Në pikën 3, fjalia e fundit shfuqizohet.

4. Në pikën 4, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:

“Kolegji Administrativ grykon me 3 gryqtarë të gjitha çështjet, me përjashtim të rekurseve të paraqitura kundër vendimeve të Grykatës Administrative të Apelit që kanë shqyrtuar padi ndaj

aktit nënljigjor normativ si dhe gjykimeve në seancë gjyqësore për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, të cilat gjykohen me 5 gjyqtarë.”.

5. Pika 5, ndryshohet si më poshtë:

“5. Trupi gjykues kryesohet nga kryetari i kolegjit dhe në mungesë të tij, nga gjyqtari relator. Në rastin kur në trup gjykues është kryetari i gjykatës, ai kryesohet nga ky i fundit.”

#### **Neni 7**

Në neni 32, pika e 2, ndryshohet si më poshtë:

“2. Kolegjet e Bashkuara shqyrtojnë çështjet kur lind nevoja për ndryshimin e praktikës gjyqësore të njësuar sipas rregullave të caktuara në legjislacionin procedural civil, penal dhe administrativ në fuqi.”

#### **Neni 8**

Në nenin 34, pika 6, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në shkronjën “b” numri “10” zëvendësohet me numrin “5”.
2. Shkronja “e” shfuqizohet.

#### **Neni 9**

Në nenin 42 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Titulli i nenit ndryshohet në “Ndhmësit ligjorë të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit”.

2. Pika 1, ndryshohet si më poshtë:

“1. Pranë gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit mund të funksionojë njësi e shërbimit ligjor, e përbërë nga ndihmësit ligjorë, e krijuar me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Pas pikës 1, shtohet pika 1/1 si më poshtë:

1/1. Këshilli i Lartë Gjyqësor cakton numrin e ndihmësve ligjorë për çdo gjykatë duke u bazuar në domosdoshmërinë e tyre për mbarëvajtjen e punës në gjykatë, pasi ka vlerësuar kriteret e përcaktuara në nenin 15, pika 3, shkronja “b”, të këtij ligji, llojin dhe natyrën e çështjeve për t’u përpunuar dhe përgatitur nga ndihmësit ligjorë si dhe pas marrjes së mendimit të Këshillit të Gjykatës, Ministrisë të Drejtësisë dhe Ministrisë të Financave. Numri i ndihmësve ligjorë nuk mund të jetë më i madh se numri i përgjithshëm i gjyqtarëve.

4. Pika 10 ndryshohet si më poshtë:

“10. Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton rregulla të detajuara për kushtet dhe kriteret profesionale që duhet të përmbushin ndihmësit ligjorë në gjykatat e shkallës së parë dhe gjykatat e apelit, llojin dhe natyrën e detyrave të ndihmësve ligjorë, llojin dhe natyrën e çështjeve për t’u përpunuar dhe përgatitur nga ndihmësit ligjorë, për kriteret dhe procedurat për ndarjen e çështjeve me short, si dhe vlerëson rregullisht ngarkesën e punës së ndihmësve ligjorë dhe siguron një numër të përshtatshëm të tyre për çdo gjykatë.

#### **Neni 10**

Në nenin 50, shkronja “c”, ndryshohet si më poshtë:

“c) ndihmësi ligjor në gjykatën e shkallës së parë dhe gjykatën e apelit;”

#### **Neni 11**

Në nenin 53 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 4, shkronja “a” ndryshohet si mëposhtë:

“a) të verifikojë plotësimin nga kandidatët të kritereve të përgjithshme dhe të veçanta për vendin e punës, si dhe të pasurisë dhe figurës;”

2. Në pikën 9, pas fjalisë së parë, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Për verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatëve ndiqen të njëjtat rregulla si dhe për kandidatët për formimin fillestar për magjistratë sipas Ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.”

#### **Neni 12**

Në nenin 56, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 2, pas togjalëshit “Për pozicionin në ndihmësit ligjorë në” shtohet togfjalëshi “gjykatat e shkallës së parë dhe”.

2. Në pikën 2, shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

b) të kenë përvojë profesionale jo më pak se tre vjet, si nëpunës në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike, profesionet e lira ligjore, mësimdhënie në fakultetet e drejtësisë, ose në çdo pozicion tjetër të barasvlerëshëm me to, në sektorin privat ose organizatat ndërkombëtare.”

#### **Neni 13**

Në nenin 64, pika 10, shfuqizohet.

#### **Neni 14**

Në nenin 85, pasi pikës 2, shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1 Sekretarët gjyqësor në detyrë që kanë mbi 3 vjet përvojë pune në këtë pozicion dhe janë me arsim të lartë, kriteri i diplomimit në drejtësi nuk përbën shkak për të mos njohur statusin e nëpunësit gjyqësor civil, nëse Këshilli i Gjykatës vlerëson pozitivisht performancën e tij në punë.”

#### **Neni 15**

Pas nenit 83, shtohet neni 83/1 me këtë përmbajtje:

##### **Neni 83/1**

#### **Përvoja profesionale e zëvendëskryetarit të gjykatës**

Përgjashtimisht, deri në përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve sipas ligjit, kandidati për zëvendëskryetar të gjykatës së shkallës së parë duhet të ketë të paktën tre vjet përvojë profesionale si gjyqtar ndërsa kandidati për zëvendëskryetar të gjykatës së apelit duhet të ketë të paktën tre vjet përvojë profesionale si gjyqtar i gjykatës së apelit.

#### **Neni 16**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

**K R Y E T A R I**

**GRAMOZ RUÇI**